



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 923/16 Prot.

Tiranë më 9.10.2020

URDHËR

Nr. 157, datë 9.10.2020

PËR KONTROLLUESIN "ELITE CONSULTING SHPK"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar (në vijim, "Ligji"), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" (në vijim, "Kodi i Procedurave Administrative"), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Elite Consulting" SHPK,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 138, datë 03.09.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, "Komisioneri"), u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "Elite Consulting" SHPK (në vijim, "Kontrolluesi"), me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga znj. V.L. në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, konstaton se:

1. Kontrolluesi ka si objekt të veprimtarisë tregtare "Shërbim për mbledhjen e borxheve, Këshillim për Tregjet & Kreditë, Konsulencë Financiare, Konsulencë Fiskale. Ndërmjetësim në shitjen e pronave të paluajtshme. Konsulencë juridike dhe ligjore."

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave "punëmarrës", "klientë" dhe "vizitorë". Të dhënat përpunohen manualisht.

2. Në kuadër të garantimit të sigurisë së ambienteve ku ushtron veprimtarinë, Elite Consulting SHPK ka instaluar një sistem video-survejimi (CCTV).

Elite Consulting SHPK ka vendosur tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video survejimit, por konstatohet se kamerat janë të pozicionuara në ambientet e brendshme të zyrave, në kundërshtim me parashikimeve të përcaktuara në pikën 10.2 të Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr.11”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se instalimi i sistemit të video survejimit, në ambientet e punës së punëmarrësve, cenon privatësinë e këtyre të fundit dhe është në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë së përpunimit të të dhënave, të sanksionuar në germën “c” të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit, pasi sistemi i video survejimit duhet të konsiderohet si mjete i fundit për të realizuar qëllimin e përpunimit.

Instalimi dhe përdorimi i sistemit të video survejimit duhet të bëhet në atë formë që përpunimi i të dhënave të kryhet në përputhje me të drejtat themelore të njeriut, të drejtën për privatësi dhe të drejtën për jetë private dhe familjare.

Për përpunimin e të dhënave me anë të sistemit të video survejimit, duhet që lloji, specifikimet e kamerave dhe vendosja e tyre të jenë në përputhje me qëllimin për të cilin do të përdoren. Kamerat nuk duhet të pozicionohen dhe të marrin imazhe nga ambiente të cilat nuk përputhen me qëllimin e mbikëqyrjes.

Kamerat mund dhe duhet të përdoren në mënyrë që të synojnë vetëm identifikimin e qartë të problemeve të sigurisë, duke zvogëluar sa më shumë të jetë e mundur regjistrimin e imazheve të panevojshme për qëllimin e përpunimit. Kjo përjasje jo vetëm që zvogëlon shkeljet e mundshme të privatësisë, por gjithashtu mundëson përdorimin e kamerave CCTV në mënyrë më efektive.

Në lidhje me sistemin e video survejimit, Kontrolluesi pretendon se kamerat, e vendosur në ambientet e punës, janë të përligjura për shkak se janë vendosur për të garantuar sigurinë e punonjësve dhe shërbejnë vetëm për vëzhgim.

Zyra e Komisionerit vlerëson se këto raste janë indikative dhe jo shteruese. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave nëpërmjet sistemit të video survejimit duhet t’i nënshtrohet kriterëve dhe rregullave të përcaktuara në Udhëzimin nr. 11 të Komisionerit.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 29, 30 pika 1, germa “b” dhe 32 të Ligjit,

U R D H Ë R O J :

1. Kontrolluesi të realizojë në mënyrë të menjëhershme ndërprerjen e përpunimit të të dhënave imazhe-video të subjekteve të të dhënave, duke hequr kamerat e cituar në pikën 2 të këtij Urdhri, e cila është në tejkalim të qëllimit të përpunimit të parashikuar në germën “c” pika 1 të nenit 5 të Ligjit;

2. Kontrolluesi të shkatërrojë të dhënat imazhe-video të grumbulluara në sistemin e video survejimit (CCTV), siç tregohet në pikën 1 më sipër, në kundërshtim me dispozitat e nenit 5 të Ligjit;
3. Kontrolluesi gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar, të ketë në vëmendje zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 11;
4. Kontrolluesi të përmbushë detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) menjëherë, detyrimet e parashikuara në pikën 1 dhe 2; dhe
 - (ii) në vazhdimësi, detyrimin e parashikuar në pikën 3.Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;
5. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra.
6. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Urdhrave të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative.

Ky urdhër u shpall sot më, 19.10.2020

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

